

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
NR—1703—REP  
NR—841—KOL



Taksa e pullës u pagua

## KONTRATË SHIT-BLERJE E KUOTAVE TË KAPITALIT

*Në bazë të Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008  
për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"*

Sot më datë 01 Shtator 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë) ditën e Shtunë para meje Noterit **Sokol Sh. MALAJ**, Noter në dhomën e Noterisë Tiranë me seli në Rr."L.Gurakuqi" u paraqitën personalisht:—

### **PALA SHITËSE:**

**Z. ERALD ZAJMI** i biri i Gëzim dhe Fatbardha lindur në Tiranë më 06.07.1984, banues në Tiranë, Rr"Qemal Stafa", Pall 195, Shk 2, Ap 22, i identifikuar me Pasaportën BF7240267 me Nr personal #I40706063O#.—

### **PALA BLERËSE:**

**Z. LEONARD SELISHTA** i biri i Vasil dhe Makbule lindur në Durrës më 13.06.1977, banues në Durrës, Lagja Nr 2, Rr"Karl Topia", i identifikuar me Kartën e Identitetit #030742240# me Nr personal #H70613072B#, ka rënë dakord t'i shesë kuotën prej 33% të kapitalit;

**Z. MEIVIS STRUGA** i biri i Arben dhe Fatlinda lindur në Tiranë më 03.11.1989, banues në Tiranë, Rr"Xh. Martini", Pallati "Teuta Konstruksion", i identifikuar me Pasaportën BR4620165 me Nr personal #I91103046V#.—

Të lartpërmendurit janë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët pasi u sqaruan për pasojat juridike që sjell ky akt noterial, deklaruan se lidhin Kontratën e shitblerjes të kuotave të kapitalit me kushtet si vijon:—

Pala shitëse, me vullnetin e saj të lirë e të plotë deklaroi se është Ortak i Vetëm në kuotën prej 100% i shoqërisë „**ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGMENT COMPANY**“ **Sh.p.k**, e Regjistruar si person juridik pranë QKB më datë 08.02.2018 me Nr unik të identifikimit të subjektit NIPT- **L81408510S**, e cila ndodhet me seli në Durrës, Rrashbull, Fshati Vrrine, Godine 1 Katëshe, Zona Industriale, me Nr pasurie 22/36, Zona Kadastrale 3339, dhe me Administrator **Z.ERALD ZAJMI**.—

Nisur nga interesat e tij dhe në bazë të Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm me Nr.1 datë 01.09.2018 vërtetuar kjo me Vërtetimin noterial me Nr 1701REP të datës 01.09.2018, i hartuar/ noterizuar nga Noter Sokol Sh. MALAJ, Ortaku i Vetëm **Z. ERALD ZAJMI** ka vendosur

të shesë pjesërisht nga kuota e tij të kapitalit, kuotën prej 66% në favor të blerësve **Z. LEONARD SELISHTA** dhe **Z. MEIVIS STRUGA**, e konkretisht:

- Blerësit **Z. LEONARD SELISHTA** i shet kuotën prej 33% të kapitalit;
- Blerësit **Z. MEIVIS STRUGA** i shet kuotën prej 33% të kapitalit;

Çmimi i shitjes, për të gjithë pjesën prej 66%, në bazë të marrëveshjes së arritur nga palët jashtë kësaj Zyre, është caktuar në vlerën prej **66.000 ALL** (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë lekë).—

Pala shitëse deklaron se kjo shumë i është likuiduar plotësisht jashtë kësaj zyre nga pala Blerëse, me para në dorë (CASH) respektivisht shumën prej **33.000 ALL** (tridhjetë e tre mijë Lekë) secili blerës për kuotën e tij prej 33% të kapitalit.—

Edhe Blerësit **Z. LEONARD SELISHTA** dhe **Z. MEIVIS STRUGA** deklarojnë se pranojnë të blejnë kuotën në total prej 66,00% të kapitalit në shoqërinë e mësipërme (ku secili merr/përfiton kuotën prej 33% të kapitalit) në çmimin që ata kanë caktuar në marrëveshje të përbashkët, shumë kjo që i është likuiduar plotësisht shitësit jashtë kësaj zyre me para në dorë (CASH), nga ku:

- Blerësi **Z. LEONARD SELISHTA** ka likuiduar shumën prej **33.000 ALL** (tridhjetë e tre mijë Lekë), për kuotën prej 33% të kapitalit, dhe
- Blerësi **Z. MEIVIS STRUGA** ka likuiduar shumën prej **33.000 ALL** (tridhjetë e tre mijë Lekë), për kuotën prej 33% të kapitalit.—

Me likuidimin e plotë të vlerës së shitjes, pra të çmimit prej **66.000 ALL** (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë lekë), shitësi e humbet pjesërisht të drejtën e pronësisë në kuotën prej 66% të kapitalit, ndërsa Blerësit **Z. LEONARD SELISHTA** dhe **Z. MEIVIS STRUGA** fitojnë pronësinë në kuotën respektive prej 33,00% të kapitalit secili.—

Pra, me hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akti Noterial, shitësi **Z. ERALD ZAJMI** humbet bashkëpronësinë për një pjesë të kuotës së tij të kapitalit në këtë shoqëri dhe blerësit **Z. LEONARD SELISHTA** dhe **Z. MEIVIS STRUGA** bëhen ortakë të ri të shoqërisë në kuotën prej 33,00% të kapitalit secili.—

Blerësit janë të detyruar të paraqesë pranë **Q. K. B.** Vendimin e Ortakëve dhe aktin noterial të shitjes se kuotave në favor të ortakëve të ri të shoqërisë **Z. LEONARD SELISHTA** dhe **Z. MEIVIS STRUGA**.—

Me nënshkrimin dhe regjistrimin e këtij akti pranë QKB, ortakët e shoqërisë „**ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGMENT COMPANY**“ Sh.p.k do të kenë kuotat e kapitalit konkretisht:

- **Z. LEONARD SELISHTA** bëhet ortak në kuotën prej **33% të kapitalit**.—
- **Z. MEIVIS STRUGA** bëhet ortak në kuotën prej **33% të kapitalit**.—
- **Z. ERALD ZAJMI** mbetet ortak në kuotën prej **34% të kapitalit**.—

Palët/ortakët e rinj janë dakord që Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare nga data e regjistrimitit në QKB, do të jetë Z. ERALED ZAJMI.—

Për të vërtetuar sa më sipër, u hartua prej meje Noterit kjo kontrate Shit-Blereje e kuotave të kapitalit e cila pasi u lexua nga palët dhe u gjet sipas vullnetit të palëve, u nënshkrua në praninë time sipas ligjit dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—

**PALA SHITËSE:  
Z. ERALED ZAJMI**



**PALA BLERËSE:**

**Z. LEONARD SELISHTA**

Leonard Selishta



**Z. MEIVIS STRUGA**

Meivis Struga

**NOTERI  
SOKOL SH. MALAJ**



**NOTER SOKOL SH. MALAJ**  
RR "LUIGJ GURASHTI" P 2 TIRANE, ALBANIA  
Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5355 4  
e-mail: kolimalaj@hotmail.de